



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 28 paragrafi 2 pika (l) lidhur me nenin 29 paragrafi 2 pika (d), të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, e në zbatim të Shkresës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe infrastrukturës, Nr. 7035-2/2023, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M
Për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-74231

Neni 1

Me këtë vendim shfuqizohet vendimi, 01-Nr-016-74231, i datës 27.11.2023, më të cilin bëhet ndryshimi i emërimit të pronave të shkollave sipas emrave aktual në regjistrin e pronave në librin kadastral pasi që në certifikate e pronësisë figurojnë me emërtime të vjetra.

Neni 2

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI